



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:228046
Datë: 24.02.2023
Numri i dokumentit: 04013071

C-IV - 15- 1312

Paditësi : A T e K, në Prishtin ‘N’

Kundër

Të paditurës : Agjencia Kosovare e Privatizimit - (AKP) Rr. “ Driton Hoxha” nr. 23, Prishtinë, për NSH „ Produkt ” në likuidim .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva , më 22 shkurt 2023, merr këtë :

A K T G J Y K I M

- I. Ankesa e paditësi A T e K në Prishtinë refuzohet si e pabazuar ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit MIT 008- 0004, më dt. 01.07.2015 .**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës .**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 10 korrik 2015 A T e K (ATK) si paditës parashtri ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër të paditurit në lidhje me vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) për NSH Produkt MIT 008-0004, më dt. 01.07.2015, me të cilin është pranuar pjesërisht kërkesa në shumën 269.78€, ndërsa është refuzuar kërkesa në shumën 775.86€ .

A T e K kërkon nga Dhoma e Posaçme që të aprovojë ankesën e saj si të bazuar dhe ta anuloi vendimin kontestues .

Në mbështetje të ankesës, ankuesi ka dorëzuar provat :

- Vendimin e AL-së, MIT 008- 0004,
- Formulari i kërkesës kreditore, 11.07.2014,
- Pasqyra e borxhit të NSH Produkt .

Më 27.12. 2022, e paditura AKP-ja me parashtrësë me shkrim në mbrojtje është deklaruar se e kundërshton në tërësi ankesën e paditësit si të pa bazuar. AL me vendimin e saj MIT 008-0004, ka pranuar një pjesë të kërkesës së paditësit, në shumën 269.78€, ndërsa pjesën tjetër e ka refuzuar në shumën 775.86€, ndërsa shuma e kërkuar ishte 1,045.63€.

AKP është deklaruar se pjesa refuzuese është bazuar në dispozitën e nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 që parashikon ,, Të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatat dhe çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos e tejkaloj 10 % të shumes themelore ”.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Me dispozitën e nenit 31.1 të Ligjit nr. 04/L- 034 rregullohet ,, Ky ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër të së drejtës në Kosovë që është në kundërshtim me të. Pa paragjykim ndaj aplikimit të përgjithshëm të fjalisë së mëparshme, parashihet në mënyrë specifike që Ligji për Procedurën Administrative nuk do të vlejë:

1.1.për çfarëdo veprimi të ndërmarrë nga Agjencia sipas autorizimeve të këtij ligji lidhur me privatizimin, likuidimin, shitjen, transferimin, restrukturimin, riorganizimin apo mënyrat tjera të zgjidhjes së një ndërmarrje, korporate apo aseti, dhe

1.2.për trajtimin dhe përcaktimin nga Agjencia të autoritetit të likuidimit të çfarëdo pretendimi apo interesi të bërë apo të pohuar nga cilido person si kreditor apo pronar i supozuar ”.

Me dispozitën e nenit 37, paragrafi 1 , 2 dhe 3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L- 086 rregullohet ,, 1. Dispozitat e këtij neni kanë efekt superior mbi dispozitat e mundshme kontradiktore të kontratave, zgjidhjeve, marrëveshjeve, aktgjykimeve apo rregullimeve tjera të lidhura nga Ndërmarrja apo në emër të saj. 2. Kërkesat për para që janë të dhëna në valutë tjetër, dhe jo në Euro, konvertohen në Euro me anë të normës së këmbimit të datës së Vendimit të Likuidimit. Kërkesat për para të dhëna në valutë që më nuk ekziston apo që është zëvendësuar me një valutë tjetër para datës së nxjerrjes së Vendimit të Likuidimit, do të konvertohen në valutën apo vulat

pasardhëse duke shfrytëzuar normën e këmbimit që ishte në fuqi në kohën kur valuta është zëvendësuar dhe pas kësaj date do të date do të shndërrohen në Euro, në bazë të normës së këmbimit që ka qenë në fuqi në datën e lëshimit të Vendimit të Likuidimit. 3. Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore ”.

Gjykata konstaton se Ligji nr. 04/L- 086 dhe Shtojca për Agjencinë Kosovare të Privatizimit e me të cilën Shtojcë rregullohen procedurat e likuidimit, është ligj me përparësi dhe mbizotëron ndaj Ligjit nr. 03/L- 222 për ATK –në .

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret e padituria AL, për NSH Produkt me vendimin nr. MIT 008- 004, dt. 01.07.2015, ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore në pjesën kur e ka refuzuar kërkesën e paditësit.

Dispozita e nenit 73 .3 e Shtojcës ka të bëjë me dy kategori ligjore , e para është shuma themelore e kërkesës së kreditore dhe e dyta është kamata për shumën themelore të saj. (kryegjënë) e cila llogaritet deri para datës së Vendimit për likuidim, me kusht që kjo kamat të mos tejkalon 10 % të shumës themelore (kryegjënë) .

Gjykata nuk është lëshuar në vlerësim të lartësisë së shumës së refuzuar me Vendim e AL, por vetëm në aspektin e bazës juridike, sepse në pjesën e shumës në mes palëve nuk ka pasur kundërshtime, por si kontestuese ishte baza juridike .

Gjykata, me rastin e vendosjes, për këtë rast ka pasur parasysh edhe praktikën e krijuar juridike në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

Prandaj , në bazë të arsyeve si më lartë dhe në pajtim me Nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës :

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti heqë shpenzimet e veta, pasi paditësi e ka humbur kontestin, ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar

Numri i lëndës: 2022:228046
Datë: 24.02.2023
Numri i dokumentit: 04013071